




REPUBLIKA E MAQEDONISË  
KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE  
SHKUP



Në bazë të nenit 31 paragrafi 2 alineja 2 dhe 40-a në lidhje me nenin 113-b të Kodit zgjedhor („Gaz.zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11 –142/12, 31/13, 34/13 dhe 14/2014, Komisioni Shtetëror i zgjedhjeve, në seancën e mbajtur më 14.03 2014, miratoi

## UDHËZIM

**për implementimin e e nenit 113-b të Kodit zgjedhor për votimin e zgjedhësve të cilët janë anëtarë të këshilleve zgjedhorë të cilët e zbatojnë votimin në përfaqësitë diplomatiko-konzulare, përkatësisht në zyrat konzulare**

Zgjedhësit të cilët janë anëtarë të këshilleve zgjedhorë të cilët e zbatojnë votimin në përfaqësitë diplomatiko-konzulare (në tekstin e mëtejme PDK), përkatësisht në zyrat konzulare tri ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë votojnë në selinë e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve.

### I..Materiali i votimit

1. Për votimin e zgjedhësve të cilët janë anëtarë të këshilleve zgjedhorë të cilët e zbatojnë votimin në PDK, përgaditen ekstrakte të veçanta të Listës zgjedhore, të sistematizuara nëpër komuna sipas adresës së përhershme të banimit.
2. Për votimin e zgjedhësve të cilët janë anëtarë të këshilleve zgjedhorë të cilët e zbatojnë votimin në PDK, posaçërisht do të shtypen fletëvotime sipas komunave ku e kanë vendin e banimit. Do të shtypen aq fletëvotime sa zgjedhës janë të regjistruar në ekstraktet e veçanta të Listës zgjedhore.
3. Materiali zgjedhor për votim në KSHZ, posaçërisht do të jetë i paketuar dhe bashkë me materialin e besueshëm zgjedhor (ekstrakte të veçanta të Listës zgjedhore, fletëvotime, procesverbalë- Formulari nr.17gs në zarfe për secilën komunë) do ti dorëzohet këshillit zgjedhor kompetent për zbatimin e votimit.

### II. Dorëzimi i materialit zgjedhor nga KSHZ në KZ

1. Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, këshillit zgjedhor i dorëzon materialin në vijim:
  - ekstrakte të veçanta të Listës zgjedhore për votimin e zgjedhësve të cilët janë anëtarë të këshilleve zgjedhorë të cilët e zbatojnë votimin në PDK.
  - numri përkatës i fletvotimeve, aq sa ka zgjedhës të kësaj kategorie.
  - zarfe të zbrazura
  - procesverbale (Formulari nr.17gs) për secilin komunë ndaras.

### **III. Procedura e votimit**

1. Votimi për këtë kategori zgjedhësish kryhet në këtë mënyrë:

- Zgjedhësi e nënshkruan ekstraktin e veçantë përkatës të Listës zgjedhore.
- Zgjedhësit i jepet zarf të zbrazur për fletëvotim dhe fletëvotim sipas vendbanimit të përhershëm. Para se ti jepet fletëvotimi në anën e përparme vulozet, ndërsa në zarf të zbrazur nga këshilli zgjedhor shënohet komuna ku zgjedhësi eka banimin e përhershëm.
- Zgjedhësi, pas votimit fletëvotimin e vendosë në zarfin e zbrazur, e ngjet zarfin dhe lëshon në kuti të votimit.
- Këshilli zgjedhor, pas mbarimit të votimit fletëvotimet e papërdorura i asgjëson duke iu këputur këndin e poshtëm dhe me stilolaps duke i shlyer për së gjati dhe i vendosë në zarfe të veçanta ku shënon komunën dhe i shkruan me shenjë FLETËVOTIME TË PAPËRDORURA, në zarf shënon numrin e fletëvotimeve të papërdorura.
- Këshilli zgjedhor, pastaj hap kutinë e votimit dhe zarfet (pa i hapur) i selekton sipas komunave dhe përpilon procesverbal ndara për secilën komunë.
- Zarfet me fletëvotime të papërdorura, ekstraktin e veçanta të Listës zgjedhore dhe procesverbalët paketohen në zarf të madh për secilën komunë dhe shënohet emri i komisionit komunal përkatës të zgjedhjeve.
- Këshilli zgjedhor, materialin zgjedhor të paketuar e vendos në kuti të votimit dhe kutinë e mbyll me shirit sigurues të numeruar. Materiali zgjedhor deri në përfundimin e zgjedhjeve për kryetar të Republikës së Maqedonisë ruhet në lokalet e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve.

### **IV. Dorëzimi i materialit zgjedhor dhe sumimi i rezultateve të votimit.**

1. Këshilli zgjedhor pas mbarimit të votimit për kryetar të Republikës së Maqedonisë në KSHZ, me anë të postës së shpejtë materialin zgjedhor e dorëzon në komisionet komunale të zgjedhjeve ku zgjedhësit kanë banim të përhershëm.
2. Komisionet komunale të zgjedhjeve, rezultatet e votimit të zgjedhësve të cilët janë anëtarë të këshilleve zgjedhorë të cilët e zbatojnë votimin në PDK i sumojnë në Procesverbalin për sumimin e rezultateve. Kjo procedurë ndërmirret pasi të pranohet materiali i përgjithshëm zgjedhor për atë komunë.

V. Ky Udhëzim me ditën e miratimit hyn në Fuqi.

VI. Ky Udhëzim shpallet në veb faqen e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve.

**VENI RE:** Komisioneve komunale të zgjedhje, të cilët rajonet e tyre kanë anëtarë të këshilleve zgjedhorë për votim në PDK, përkatësisht zyrat konzulare do të pranojnë edhe lista të zgjedhësve të kësaj kategorie

**KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**KRYETAR**

**Nikolla Rillkoski**

(vula dhe nënshkrimi personal)